



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i  
Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology*

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

DATE/A:	10.04.2018
REFERENC-Ë:	1679
PËR/ZA/TO:	z. Ramush Haradinaj - kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës
CC:	z. Shyqiri Bytyqi – Ministër i MASHT
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Heset Sahiti - Zëvendësministër i MASHT <i>H Sahiti</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Punës janar – mars 2018

*RAPORT PUNE  
Janar - mars 2018*

I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj!

Me marrjen vendimit për emërimin tim në detyrën e zëvendësministrit të MASHT, këtë detyrë e kam marr me përkushtim dhe përgjegjësi të lartë, duke qenë i vetëdijshëm për detyrën dhe rëndësinë që ka ky dikaster i Republikës së Kosovës, siç është Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Gjatë punës time në tremujorin e parë të vitit 2018, sipas Planit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Planit të punës të MASHT për vitin 2018, PSAK 2017-2021, dhe sipas kërkesave të Ministririt, kërkesave të Departamenteve të caktuara në MASHT dhe kompetencave që ka një zëvendësministër jam angazhuar që të jem në krye të detyrës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e zëvendësministrit gjatë ushtrimit të funksionit të tij, përkufizohen në Rregulloren nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

Në bazë të kësaj rregullore, zëvendësministri emërohet për mbështetjen e Ministrit dhe është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga Ministri, si dhe zëvendëson ministrin kur ai mungon ose kur nuk është në gjendje të kryej detyrën e tij.

Detyrat e zëvendësministrit janë si vijon: ndihmon Ministrin në caktimin e prioriteteve, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të Qeverisë dhe Ministrisë; me autorizim të ministrit merr pjesë në hartimin e vendimeve dhe të akteve të tjera, që rregullojnë aktivitetet e kabinetit të ministrit dhe të Ministrisë; ushtron detyra, të cilat u caktohen nga ministri; me autorizim të ministrit apo në mungesë të tij me autorizim të Kryeministrit mund të marr përgjegjësi që i janë dhënë ministrit; kryejnë detyra të tjera që parashikohen me ligje të veçanta etj.

Në bazë të këtyre parimeve dhe përgjegjësive që kam pasur, në tremujorin e parë të vitit 2018 kam kryer këto punë dhe angazhime të përditshme:

- ✓ Takimi i parë në këtë vit është mbajtur me kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj, i cili pas takimit me Ministrin, ka mbajtur takim me kabinetin e ministrit dhe me zëvendësministrin, i cili ka kërkuar angazhimet maksimale për të përmirësuar cilësinë e arsimit në Kosovë, duke ngritur cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe duke vënë në rend të parë nxënësin dhe përmirësimin e rezultetit në Programin Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve PISA, si dhe përmirësimin e kushteve nëpër shkolla sidomos kushteve sanitare.
- ✓ Kam shqyrtuar Udhëzimin Administrativ nr.3/2018 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e MASHT, DKA-ve, Shkollave dhe koordinatorëve në Organizimin, Menaxhimin, Mbikëqyrjen dhe Administrimin e të gjeturave nga Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve ( PISA).
- ✓ Shqyrtimi i Udhëzimit Administrativ 04/2018 për Investime kapitale të MASHT.
- ✓ Shqyrtimi i Udhëzimit Administrativ nr.01/2018 për parimet e njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension.
- ✓ Shqyrtimin e Udhëzimit Administrativ për arsimin e fëmijëve në Qendrat Korrektuese të Kosovës, me veçanti në QK në Lipjan.
- ✓ Shqyrtimin Udhëzimit Administrativ nr. 5/2018 për Kriteret dhe Procedurat e Emërimit të Anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.
- ✓ Kam marr pjesë në mbledhjet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në mungesë të Ministrit, i cili ishte i zënë me agjendë tjetër zyrtare si brenda ashtu edhe jashtë vendi. Në tri mbledhje të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- ✓ Kam marr pjesë në Takimin ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Shtetit Shqiptar dhe Ministrisë së diasporës të Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike të Republikës së Kosovës, e cila është mbajtur në Tiranë në të cilën kanë marr pjesë Ministri i diasporës së Shqipërisë z. Pandeli Majko, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë së Shqipërisë znj. Lindita Nikolla, mandej zëvendëskryeministri dhe ministri i Diasporës së Republikës së Kosovës z. Dardan Gashi, për të diskutuar punën e



përbashkët të grupeve të dy vendeve tona për hartimin e përbashkët të Kurrikulës për Arsimin shqip dhe kulturën shqiptare në diasporë (ky dokument është përfunduar).

- ✓ Kam marr pjesë së bashku me grupin punues për hartimin e Kurrikulës së Re për klasat 2, 7 dhe 11 me Departamentin e Arsimit Parauniversitar të MASHT, punëtori e cila ka finalizuar Kurrikulën e Re për Arsimin parauniversitar, për këto klasa i cili ka marr formën përfundimtare, dhe është gati për vitin shkollor 2018/2019.
- ✓ Marrje pjesë në mbledhjen e grupit të ekspertëve për Programe dhe tekste Shkollore, në mbledhjet e mbajtura në MASHT, grup i cili kanë finalizuar platformën për Programet, kriteret dhe konkursin për tekstet e reja shkollore.
- ✓ Kam marr pjesë në inaugurimin e renovimit të shkollave të investuara në kuadër të programit për ndihma Humanitare të Komandës së Ushtrisë Amerikane për Evropë, Zyra për bashkëpunim në mbrojtje pran Ambasadës Amerikane në Prishtinë, në shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët “Jeronim De Rada” në Ferizaj me pjesëmarrjen e Zv. Assitentes së Sekretarit të Mbrojtjes znj. Cooper, dhe në shkurt në Shkollën e Mesme Profesionale “ Bahri Haxha” në Vushtri në të cilën inaugurim mori pjesë zëvendës shefja e misionit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë, znj. Colleen Hyland.
- ✓ Gjithashtu, kam marr pjesë në Inaugurimin e Shkollës Filllore “Fazli Graiçevci” në fshatin Lajthishtë të komunës së Obiliqit, investim i Komunës së Obiliqit, ndërsa inventari i siguruar nga MASHT.
- ✓ Kam marr pjesë në mbledhjet të cilat janë mbajtur me grupin punues për organizimin mbarëvajtjes së testit PISA, ju kam shpërndarë udhëzimet për testin PISA, drejtpërdrejtë nxënësve të Komunës së Lipjanit, kjo në kuadër të aktiviteteve të grupit punues në tërë vendit për këtë Program ndërkombëtar për vlerësimin e nxënësve.
- ✓ Kam marr pjesë në punëtorinë për finalizimin e Planit të punës së MASHT për vitin 2018.
- ✓ Kam marr pjesë në mbledhjen e Këshillit Ekonomik Social (KES) në zëvendësim të ministrit, dhe njëkohësisht jam anëtarë i Komisionit për Punësim dhe Aftësim Profesional, i përbërë nga OEK, MPMS, MASHT, MTI, BSPK.
- ✓ Shqyrtimi i gjendjes aktuale në sistemin e planifikimit të MASHT, kryesisht në kuadër të Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021. Planifikimi vjetor është integruar në kuadër të Planit Vjetor të Ministrisë.
- ✓ Kam marrje pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Terapisë së Gjuhës dhe të Folur 2018 Speech Therapy Pathology Pristina International Conference 2018” në Prishtinë, e cila është organizuar nga Instituti Kosovar për Logopedi (IKL) mbajtur me sukses në ditën ndërkombëtare të logopedisë me 6 mars.
- ✓ Kam marr pjesë në Konferencën, Edukimi çelës për tu përballur me ekstremizmin dhe radikalizmin online. Fuqizimi i grupeve të marginalizuara në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm,

- ✓ Konferenca për një Internet të Sigurt, për mbrojtje të fëmijëve nga Interneti në të cilën ka marr pjesë edhe ambasadori i OSBE-së z. Jan Breaathu, në Prishtinë.
- ✓ Kam marr pjesë në Shqyrtimin e raportit mbi zbatimin e programit kombëtar për Zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim Asocimit gjatë periudhës janar - dhjetor 2017.
- ✓ Kam marr pjesë në prezantimin e Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë, të prezantuar nga përgjegjësi i divizionit në MASHT z. Burim Gashi.
- ✓ Shqyrtimin e Raportit të punës së MASHT për muajin janar 2018
- ✓ Shqyrtimi i Raportit të punës së MASHT për muajin shkurt 2018
- ✓ Shqyrtimi i Raportit të punës së MASHT për muajin mars 2018
- ✓ Pritje nga Rektori i Universitetit “ Kadri Zeka” në Gjilan Prof. dr. Bajram Kosumi.
- ✓ Takim në MASHT, me rektorin e Universitetit të Pejës “ Haxhi Zeka” Prof. dr. Alush Musaj.
- ✓ Kam marr pjesë në prezantimin e studimit “Fëmijët me nevoja të veçanta” në Anamoravë në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, dhe me rastin e përvjetorit të Universitetit “Kadri Zeka”, në të cilin përvjetor ka marr pjesë Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj.
- ✓ Kam marr pjesë në 55 vjetorin e Shkollës së Lartë Pedagogjike dhe 9 Vjetorin e Universitetit e Ukshin Hoti në Prizren.
- ✓ Kam pasur takime në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës, me rastin e përcjelljes së grupit të profesorëve të këtij fakulteti për vizitë studimore në SHBA.
- ✓ Kam marr pjesë në tre vjetorin e Klubit të Astronomëve të rinj të Kosovës, Astronomy Outreach of Kosova,
- ✓ Është dorëzuar Zyrës së kryeministrit Projektligji për punëtorët Arsimit të viteve 1990/1999, me opinionin financiar për realizimin e këtij ligji.
- ✓ Vizitë Gjinnazit “ Vëllezërit Frashri” në Deçan, me rastin e fillimit të 20 vjetorit të Epopesë së Dukagjinit, me këtë rast u njoftuam me mbarëvajtjen e mësimit në këtë Gjinnaz si dhe me kërkesat për inventar dhe kabinete të lëndëve shkencore.
- ✓ Pjesëmarrja në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës së bashku me grupin e MASHT me rastin e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet drejtores së Korpusit për Paqe, znj. Darlene Grant dhe Ministrit të MASHT z. Shyqiri Bytyqi, në prezencën edhe të Ambasadori të SHBA-së në Kosovë, z. Greg Delawie.
- ✓ Pjesëmarrja ime në zyrën e kryeministrit z. Ramush Haradinaj në mbledhjen e nivelit të lartë organizuar nga MASHT në të cilën morën pjesë Kryeministri z. Ramush Haradinaj, Zv/kryeministri z. Fatmir Limaj, zv/kryeministri z. Enver Hoxhaj përfaqësues të Akademisë së Shkencave të Kosovës, Rektorë të Universiteteve publike, Rektorë të Kolegjeve private, drejtor të DKA-ve, përfaqësues të SBASHK-ut dhe organizata të shoqërisë civile që merren me çështje të arsimit. Kjo mbledhje e këtij niveli u konsiderua hap i qëlluar për të diskutuar për gjendjen e arsimit në të



gjitha nivelet dhe mundësitë që bashkërisht të japim kontributin për të ngritur cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet.

- ✓ Kam marr pjesë në Olimpiadën e organizuar nga MAC pro, Genius dhe garën shkencore të organizuar nga Gjimnazi Hasan Nahi.
- ✓ Takime të shumta me palë në MASHT të Universiteteve, Fakulteteve, Shkollave të Mesme dhe atyre fillore nga të cilat takime merren shumë kërkesa për nevojat të institucioneve të arsimit të mesëm dhe të lartë.
- ✓ Kam qenë në dy debate televizive me përfaqësues të SBASHK-ut lidhur me Grevën e arsimtarëve për aprovimin e Ligjit për punëtorët Arsimit të viteve 1990/ 1999.
- ✓ Pritjen e delegacionit të donatorëve nga shkolla gjermane e Anne-Frank-Gesamtschule Dortmund, nga Dortmundi, së bashku me mësues shqiptarë të diasporës të cilët kanë sjellë donacione me inventar për shkollat tona në Pejë (Shkolla "Asdreni"), Prishtinë (Shkolla "Iliria"), Ferizaj (Shkolla "Jeronim de Rada") dhe Kaçanik (Shkolla "Emin Duraku") etj. Drejtorin e arsimit të qytetit të Dortmundit, zoti Peter Rieger, dhe mësuesi i Shkollës Shqipe në qytetet Dortmund, Arnsberg dhe Sundern, zoti Kemajl Çallaku (shoqëruar edhe nga anëtari i këshillit të prindërve të Shkollës Shqipe të Dortmundit, zoti Driton Musliu), dhe grupin e drejtorëve e drejtoreshave të shkollave gjermane të Dortmundit (zoti Bernd Bruns, zonja Svenja Pfeiffer, zonja Melani Froh). Donator konkret për shkollat tona.
- ✓ Kam qenë kryesues i komisionit për ndarjen e Çmimit "Shaban Jashari" i cili ndahet me rastin e Ditës së Mësuesit me 7 Mars. Këtë çmim e ka fituar mësuesja Elmie Dumani mësimdhënëse e SHFMU "Dardania" në Prishtinë. Si dhe nga ministri z. Shyqiri Bytyqi bërë ndarja e Çmimit "Shaban Jashari" dhe ndarja e mirënjohjeve të mësuesve të dalluar nga Komuniteti i Kosovës.
- ✓ Kam marr pjesë në punëtorinë për vlerësimin vjetor të PSAK 2017-2021, të organizuar MASHT me mbështetje të GIZ-CDBE (Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin Fillor), mbajtur në MASHT.
- ✓ Takim me Sekretarin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës z. Shpen TRDEVAJ me të cilin biseduam për detyrat që ka Këshilli i Sigurisë së Kosovës, ekstremizmin, dukurinë e drogës nëpër shkolla, rolin e MASHT në luftimin e këtyre dukurive, dhe për zbatimin e Strategjisë.
- ✓ Kam marr pjesë në konferencën tretë me radhe e cila mbahet për çdo vjet, organizuar në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit dhe me Fakultetin Ekonomik. Tema përkon me programet e studimit në FE si dhe me hulumtimet që po i bëjnë studiuesit në Kosovë dhe në Slloveni për "Udhëheqjen dhe menaxhimin në shkolla dhe në biznese", dhe trajtimin e kësaj temë në raport me tregun e punës.
- ✓ Takim me përfaqësuesit të kompanisë konsulentë NATHAN (Kompani konsulentë e cila është e kontraktuar nga MCC për të bërë përgatitjen e projektit) dhe përfaqësuesve të Fondacionit të Mileniumit të Kosovës (MFK). U njoftuam për programin e për Programin nga Puna Praktike në Punësim për Studente. Programi i

propozuar synon ta përmirësoj qasjen e studenteve në pune praktike dhe punësim duke iu ofruar përvojë pune dhe mentorim. Programi synon t'i përfshijë universitetet publike (UP, Universiteti i Mitrovicës, Universiteti i Pejës) dhe private (UBT, AUK), sektorin e energjisë (KEK, KEDS, KESCO, ERO), MZHE-ne, si dhe partner të tjerë në sektorin private. Gjithashtu, mendohet të përfshihen shkollat profesionale publike dhe private. MASHT mori përgjegjësinë të bashkëpunojë me MFK për të garantuar suksesin e programit të propozuar bashkëpunim ky i domosdoshëm.

- ✓ Përfaqësues nga Kolegji Heimerer, kërkojnë mundësinë rishikimin e mundësisë për ribotimin dhe lancimit të iniciativës për botimin e revistës Shëndeti 38, për jetësimin e këtij projekti mbështeten në interesimin e studentëve të këtij kolegji.
- ✓ Takime me zëvendësministrat dhe kabinetin e ministrit lidhur me koordinimin dhe mbarëvajtjen e punëve në MASHT etj.
- ✓ Kam pritur edhe palë të cilët kanë kërkuar takim me ministrin dhe me zëvendësministrin, si drejtor shkollash, drejtor të DKA-ve, kryetar të komunave, për kërkesat e tyre i kam udhëzuar të shkojnë nëpër departamentet e caktuara në vijë zyrtare, për shqyrtime të mëtejshme.

Besoj se gjitha obligimet që dalin nga legjislacioni në fuqi, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë të cilat më janë caktuar nga Ministri z. Shyqiri Bytyqi i kam kryer me nderë dhe përkushtim.

Heset SAHITI  
Zëvendësministër i MASHT





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**  
**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë – Ministarstvo**  
**Nauke i Tehnologije – Ministry of Education, Science and**  
**Technology**

- 1. Zv. Azem Guri, (është emëruar që një muaj)**
- 2. Zv. Arbër Geci, ( dorëzuar me datë 24.04.18 – 5 faqe )**
- 3. Zv. Bajrus Sezairi, ( dorëzuar me datë 18.04.18 – 5 faqe )**
- 4. Zv. Artan Berisha, ( dorëzuar me datë 19.04.18 – 5 faqe )**
- 5. Zv. Hestet Sahiti, ( dorëzuar me datë 17.04.18 – 6 faqe )**